



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.525/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, me shenjën ZL.A.nr.525/2017 e datë 24.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, me të cilën ka pretenduar se me datë 24.10.2017, rreth orës 16:00, në Formularët e Rezultateve të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, kanë vërejtur disa ndërhyrje-keqpërdorime dhe korrektime gjatë shënimit të numrit të votave dhe si pasojë e kësaj mendojnë se gjatë numërimit të votave është bërë keqpërdorim ku kandidatëve të LVV-së i është shkruar numër më i vogël i votave se që kanë pasur.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ankesës i ka bashkangjitur listën e kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, si dhe listën e Qendrave të votimit për të cilat ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në ato Qendra të votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës e subjektit politik LVV-së, dega në Drenas, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL. Anr.525/2017 më datën 26.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.